

VENDIM
Nr. 545, datë 29.9.2021

PËR KRYERJEN E PAGESËS SË DOZAVE TË VAKSINAVE DHE TË PAGESAVE RESPEKTIVE, QË RRJEDHIN NGA AKTI NORMATIV NR. 30, DATË 27.9.2021, I KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TË NËNSHKRUARA NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr. 30, datë 27.9.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryerjen, nga Instituti i Shëndetit Publik, të pagesave të përcaktuara në aktin normativ nr. 30, datë 27.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021”, në vlerën 6 009,120 (gjashtë milionë e nëntë mijë e njëqind e njëzet) USD, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit të ditën e pagesës.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2021, në llogarinë ekonomike 6050000 (produkti 91305AH) të programit “Shërbime të shëndetit publik” (07450), i shtohet ekuivalenti në lekë i shumës prej 6 009,120 (gjashtë milionë e nëntë mijë e njëqind e njëzet) USD, për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinës nga kompania *Pfizer Export B.V.*

3. Fondi, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama